

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2026

Periudha (Qershor 2026)

Nr . Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfund imit të kërkesë s	Tarifa
09	11.06.2026	1.A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar - dhjetor 2025? Nëse po, sa është ky buxhet për rininë dhe sa përqind të shumës totale të buxhetit të bashkisë zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë? 2.A ka përfituar bashkia nga projekte të financuara nga donatorë që synojnë rininë gjatë vitit 2025? Ku konsistojnë këto projekte? 3.Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2025)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 4.Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 5.Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të	19.06.2026	1.Bashkia Belsh ka një buxhet vjetor të planifikuar për rininë, me vlerë 1 000 000 lekë, nga ku kjo vlerë zë 2 % të shumës totale të buxhetit të bashkisë. 2.Gjatë vitit 2025, në bashkinë tonë nuk ka patur projekte dhe përfitime të financuara nga donatorë në fushën e rinisë. 3.Numri total i punonjësve në bashki është 116, ku 56 janë femra dhe 60 janë meshkuj, ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. Ndërsa në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme numri total i punonjësve është 115, ku 65 janë femra dhe 50 janë meshkuj, ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. 4.Numri total i të rinjve (18-29) vjeç në bashki është 28, ku 24 janë femra dhe 4 janë meshkuj, ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. Ndërsa në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme numri total i të rinjve është 22, ku nga këta 16 janë femra dhe 6 janë meshkuj, ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. 5.Numri total i të rinjve (18-29) vjeç në bashki në	E plotë	Pa pagesë

		kufizuara, edhe sipas gjinisë? 6.A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë? 7.A keni në institucionin tuaj, një strukturë, njësi (drejtori, sektorë) ose punonjës (staf) të dedikuar për çështjet e rinisë? Nëse po ju lutem specifikoni: emrin e strukturës/njesisë; numrin e stafit, përgjegjësitë kryesore). Prej sa kohësh janë funksionale? 8.A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar - dhjetor 2025. Nëse po, cilat janë ato? 9.Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individë, etj). 10.A keni një Plan Vendor Veprimi për Rininë ose dokumente të tjera që adresojnë çështjet e rinisë? Nëse po, ju lutemi të specifikoni titullin, datën e miratimit dhe periudhën e zbatimit. Ju lutemi të bashkëngjitni dokumentin. 11.Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor (KVR) në bashkinë tuaj, ju lutem përgjigjuni pyetjeve si më poshtë: -Viti i krijimit i KVR në bashkinë tuaj. -Numri i antarëve të KVR në bashkinë tuaj.		pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse është 11, ku nga këta 9 janë femra dhe 2 janë meshkuj ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. Ndërsa në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme numri total i të rinjve në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse është 1, ku nga këta 1 janë femra dhe 0 janë meshkuj, ndërsa me aftësi të kufizuara nuk ka. 6.Në Bashkinë Belsh nuk ka politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën (15-29) vjeç. Arsyet kryesore për mos zhvillimin e politikave rinore janë, kryesisht mungesa e një strukture të plotë të dedikuar për rininë, burimet e kufizuara financiare dhe administrative. 7.Përsa i përket strukturave dhe kapaciteteve funksionale të bashkisë për çështjet me të rinjtë, nuk ka një drejtor apo sektor dedikuar të rinjve, por ka një punonjës për çështjet rinore. a.Kristina Qosja b.Email: kristinaqosja912@gmail.com 8.Në Bashkinë Belsh është i ngritur këshilli rinor, i cili i dedikohet specifikisht grupmoshës (15-29) vjeç. Bashkia jonë ende nuk ka një qendër rinore, por të rinjtë kanë hapësira ku zhvillojnë mbledhjet apo aktivitetet e tyre. 9.Për ngritjen e KVR-së, institucioni ka	
--	--	--	--	--	--

		-Numri të rinj të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? -Numri i mbledhjeve të zhvilluara gjatë 2025. -Numri i aktiviteteve të organizuara nga KVR përgjatë 2025. 12.Për çfarë lloj mbështetje / iniciativa/ bashkëpunime keni nevojë për të përmirësuar funksionet e KVR në qytetin tuaj? 13.A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato? 14. Sa organizata rinore, qendra rinore ose grupe rinore operojnë në territorin e bashkisë? Cilat janë ato? 15. A ofron bashkia mbështetje për organizatat rinore? (mbështetje financiare; vënie në dispozicion të ambienteve publike; mbështetje për ngritjen e kapaciteteve; forma të tjera mbështetjeje (ju lutemi specifikoni). 16. Ju lutemi të jepni informacion mbi aktivitetet për të rinjtë të organizuara ose mbështetura nga bashkia gjatë vitit 2025, si: (aktivitete kulturore; aktivitete sportive; nisma vullnetare; nisma të angazhimit komunitar; veprimtari mjedisore). 17. Në çfarë mënyrash përfshihen të rinjtë në proceset vendimmarrëse të bashkisë? (konsultime publike, forume rinore, buxhetim me pjesëmarrje,	bashkëpunuar më shumë me grupe të rinjsh, organizata sportive pasi duke qenë bashki e vogël, nuk ka organizata rinore. 10.Në institucionin tonë nuk ka një Plan Vendor Veprimi për Rininë ose dokumente të tjera që adresojnë çështjet e rinisë. 11.Përsa i përket pyetjes 11, përgjigjet janë si më poshtë: a.KVR në Bashkinë Belsh është krijuar në vitin 2019. b.Numri i anëtarëve të KVR-së në bashkinë tonë është 6. c.Numri i të rinjëve të përfshirë në KVR është 4, ku 3 janë femra dhe 1 mashkull, por asnjëri prej tyre nuk i përket grupit si person me aftësi të kufizuara. d.Numri i mbledhjeve të zhvilluar gjatë 2025 është 2. e.Gjatë vitit 2025, në bashkinë tonë nuk ka patur aktivitete të organizuara nga KVR. 12.Bashkia Belsh ka nevojë për mbështetje, për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVR, trajnime, rritje të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, si dhe mbështetje financiare për organizimin e më shumë aktiviteteve. 13.Po, bashkëpunimi është zhvilluar kryesisht me shkollat, grupet informale të të rinjve dhe aktorë të tjerë lokalë për organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive,		
--	--	--	---	--	--

		organe këshillimore, mekanizma të tjerë). 18.Gjatë vitit të fundit (2025), sa konsultime publike me pjesëmarrjen e të rinjve ka organizuar bashkia? Sa është pjesëmarrja e të rinjve në këto konsultime? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese? 19.Cilat janë sfidat kryesore që has bashkia në angazhimin e të rinjve në proceset e vendimmarrjes lokale? 20.A përdor bashkia platforma ose mjete digjitale për të lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse? Cilat janë ato? Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram. 21.A ofron bashkia mbështetje për sipërmarrjen rinore? (grante, trajnime, mentorim, inkubim biznesi, forma të tjera mbështetjeje) 22.Ju lutemi të ndani praktika të mira, histori suksesi ose iniciativa të suksesshme që lidhen me pjesëmarrjen e të rinjve dhe që mund të përfshihen në Raportin Kombëtar të Monitorimit të Pjesëmarrjes së të Rinjve. 23.A ka masa ose programe specifike për grupet vulnerabël të të rinjve, si: (të rinjtë me aftësi të kufizuara; të rinjtë NEET (jo në arsim, punësim ose trajnim); të rinjtë romë dhe egjiptianë; të rinjtë në zonat rurale; vajzat dhe gratë e reja; grupe të tjera vulnerabël).		ndërgjegjësuere dhe vullnetare. 14.Në Bashkinë Belsh, nuk ka organizata rinore, qendra ose grupe rinore që operojnë. 15.Bashkia ofron mbështetje dhe vë në dispozicion ambiente publike për zhvillimin e aktiviteteve rinore, si dhe mbështet organizimin e aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive sipas mundësive dhe burimeve në dispozicion. Janë organizuar dhe mbështetur aktivitete sportive, aktivitete kulturore, fushata ndërgjegjësuere, nisma vullnetare, aktivitete mjedisore dhe iniciativa për angazhimin komunitar të të rinjve. 16.Disa nga aktivitetet janë: Dita e Verës e cila mbart në vetëvete aktivitet kulturor, sportiv, dita e balonave aktivitet sportiv, Festa e Afërditës aktivitet kulturor, Dita e Tokës veprimtari mjedisore, të drejtat e grave dhe mbrojtja nga dhuna, nisma vullnetare etj. 17.Të rinjtë në proceset vendimmarrëse të bashkisë përfshihen përmes konsultimeve publike, takimeve informuese, aktiviteteve të organizuara nga bashkia, forumeve me të rinjtë dhe pjesëmarrjes në iniciativa komunitare. 18.Bashkia Belsh nuk ka organizuar konsultime publike me pjesëmarrjen e të rinjëve gjatë vitit 2025.	
--	--	--	--	--	--

		24.Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 25.Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 26.Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 27.Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 28.Sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 29.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?		19.Pjesëmarrja e ulët e të rinjve, mungesa e organizatave rinore të formalizuara, emigrimi i të rinjve, mungesa e burimeve financiare dhe nevoja për mekanizma më të qëndrueshëm komunikimi dhe përfshirjeje, janë disa nga sfidat kryesore që ne hasim. 20.Po, bashkia përdor faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale për të informuar dhe përfshirë të rinjtë në aktivitetet dhe konsultimet publike. Komunikimi realizohet kryesisht përmes: a.Faqes zyrtare të bashkisë; https://bashkiabelsh.al/ b.Facebook; Bashkia Belsh – Faqja Zyrtare c.Instagram; arif_tafani_faqja_zyrtare 21.Bashkia mbështet sipërmarrjen rinore përmes informimit të të rinjve mbi programet kombëtare, bashkëpunimit me institucione partnere dhe orientimit drejt mundësive të trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale. Aktualisht nuk ka një skemë të dedikuar financiare të bashkisë për grante apo inkubim biznesi. 22.Një praktikë e mirë ka qenë përfshirja e të rinjve në aktivitete komunitare, mjedisore, sportive dhe kulturore të organizuara nga bashkia. Bashkëpunimi me shkollat ka ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në nisma vullnetare,	
--	--	--	--	--	--

				aktivitete ndërgjegjësuese dhe në promovimin e qytetarisë aktive. 23.Bashkia, nuk ka programe specifike për grupet vulnerabël të të rinjve. 24.Për vitin 2025 numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike është 466 (familje), ku 916 janë femra dhe 876 janë meshkuj. 25.Numri i të rinjve sipas gjenerimit nga sistemi për grupmoshat 0-17 vjeç është 599, dhe grupmosha 18-40 vjeç është 617, ndërsa ndarja femra-meshkuj në total është 916 femra dhe 876 meshkuj për të gjitha grupmoshat sipas ndarjes në sistem. 26.Numri total i Përfituesve të Pagësës së Paaftësisë së Kufizuar (PAK) është 1181, ku 594 janë femra dhe 587 janë meshkuj. 27.Numri i të rinjve Përfitues të Pagësës së Paaftësisë së Kufizuar (PAK) është 70, ku 38 janë femra dhe 32 janë meshkuj. 28.Numri total i personave të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 është 59, ku 16 janë femra dhe 43 meshkuj. 29.Numri i të rinjve (15-29) vjeç të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 është 6, ku të cilët 0 janë femra dhe 6 meshkuj		
--	--	--	--	---	--	--

10	23.06.2026	1.Politika Bashkiake dhe Përgjegjësia Institucionale 1.1 A ka bashkia ndonjë vendim, rregullore apo plan zyrtar për mirëqenien e kafshëve dhe menaxhimin e kafshëve endacake? Ju lutemi bash këngjitni dokumentet përkatëse. 1.2 Kur është përditësuar për herë të fundit ky dokument apo kjo praktikë? 1.3 Cila strukturë në bashki është aktualisht përgjegjëse për këto çështje? 2. Censusi, Infrastruktura dhe Shërbimet e Strehimit 2.1 A ka bashkia census ose vlerësim të numrit të qenve dhe maceve endacake në territorin e saj? 2.2 A keni informacion mbi numrin e kafshëve në pronësi të qytetarëve? 2.3 A ka bashkia në pronësi ose nën menaxhim një ose më shumë strehë kafshësh? Nëse po, ju lutemi specifikoni: nr. e strehave, adresën, vitet në funksion, numrin dhe pozicionet e punësve, kapacitetin strehues, shërbimet (kujdes mjekësor, sterilizim, birësim), buxhetin vjetor, bashkëpunimin me OJQ dhe aksesueshmërinë nga publiku. 3. Programet e Kontrollit të Kafshëve Endacake 3.1 A zbaton apo financon bashkia programe sterilizimi, vaksinimi apo kapjeje për kafshët endacake? 3.2 Ju lutemi jepni të dhëna vjetore për 4 vitet e fundit (2022–2025): numrin e kafshëve të sterilizuara, vaksinuara ose të kapura. 3.3 Programet ofrohen vetëm nga bashkia apo në	26.06.2026	1.Bashkia Belsh nuk ka vendim, rregullore apo plan zyrtar në lidhje me garantimin e mirëqenies dhe menaxhimin e kafshëve endacake. 2.Nuk kemi një census ose një ide të numrit të qenve dhe maceve endacake dhe as për kafshët në pronësi të qytetarëve. Gjithashtu bashkia nuk ka në pronësi ose nën menaxhim strehë për kafshët edacake. 3.Bashkia nuk zbaton apo financon ndonjë program sterilizimi, vaksinimi apo kapjeje për kafshët endacake. 4.Bashkia ka patur në vitin 2025, në strukturë veteriner që mbulonte shërbime emergjente për kafshët endacake, por nuk ka patur shërbime veterinarë të kontraktuara apo të mbështetura nga bashkia dhe nuk ka klinika të lëvizshme. Ndërsa për vitin 2026 nuk e ka në strukturë një veteriner. 5.Nuk kemi organizuar apo mbështetur fushata publike mbi mirëqenien e kafshëve dhe nuk ka ndonjë program të zbatuar në shkolla apo qendra komunitare. 6.Bashkia nuk ka një linjë buxhetore të dedikuar për qëllimin e menaxhimit dhe garantimit të mirëqenies së kafshëve dhe nuk ka përfituar fonde nga donatorë, programe shtetërore apo OJF për mirëqenien e kafshëve endacake. 7.Nuk ekziston një kanal zyrtar që qytetarët të	E plotë	Pa pagesë
----	------------	---	------------	---	---------	-----------

	bashkëpunim? Nëse bashkëpunoni, me cilët? 4. Shërbimet Veterinare dhe Aksesueshmëria 4.1 A ka shërbim veterinar të kontraktuar apo të mbështetur nga bashkia? 4.2 A ofrohen shërbime emergjente për kafshët endacake? 4.3 A ka klinika të lëvizshme apo shërbime për zonat rurale? Ju lutemi rendisni shërbimet dhe partnerët e përfshirë. 5. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik 5.1 A ka mbështetur apo organizuar bashkia fushata publike mbi mirëqenien e kafshëve, sterilizimin, birësimin apo ndërgjegjësimin kundër mizorisë në 4 vitet e fundit (2022–2025)? Nëse po, rendisni secilën dhe vitin. 5.2 A ka programe aktive në shkolla apo qendra komunitare? 6. Buxheti dhe Financimi 6.1 A ka bashkia linjë buxhetore të dedikuar për mirëqenien e kafshëve? 6.2 Nëse po, cilat shuma janë alokuar në 4 vitet e fundit (2022–2025)? 6.3 A ka përfituar bashkia fonde nga donorë, programe shtetërore apo OJQ? Nëse po, rendisni burimet. 7. Mekanizmat e Ankesave dhe Raportimit 7.1 A ekziston kanal zyrtar (telefon, email, platformë dixhitale) për raportimin e problemeve me kafshët endacake apo rasteve të keqtrajtimit? 7.2 Sa ankesa janë regjistruar në 4 vitet e fundit (2022–		raportojnë për kafshët endacake, abuzime apo shkelje të mirëqenies së kafshëve, por është zyra e One Stop Shop për të bërë kërkesë-ankesat por edhe faqja zyrtare e webit e bashkisë, nëse qytetarët duan të raportojnë shqetësimet e tyre në lidhje me çështjet e mësipërme. Deri më tani nuk kemi patur raporte që lidhen me kafshët endacake nga turistët ose qytetarë që jetojnë në territorin e bashkisë. 8.Jo, bashkia nuk përfshin në strukturat e saj inspektorë, oficerë apo staf të dedikuar për monitorimin e mirëqenies së kafshëve.	
--	---	--	--	--

		2025) dhe çfarë veprimesh janë ndërmarrë? 7.3 A keni pasur raporte nga turistë ose qytetarë të huaj për probleme me kafshët endacake? 8. Stafi dhe Mbikëqyrja 8.1 A ka bashkia inspektorë, oficerë apo staf të dedikuar për monitorimin e mirëqenies së kafshëve? 8.2 Nëse po, sa persona janë të caktuar dhe në cilën strukturë?				
--	--	--	--	--	--	--